

VENDIM
Nr. 621, datë 24.7.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË KONKURRIMIT PËR DHËNIEN ME QIRA, ME
ÇMIMIN 1 (NJË) EURO KONTRATA, TË SIPËRFAQES PREJ 103 550 M² NË ADMINISTRIM
TË NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇELIQEVE, ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve” dhe të pikës 1 të kreut V të vendimit nr. 529, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien me qira, me çmimin 1 (një) euro/kontrata, të pasurisë “Sipërfaqe e lirë prej 103 550 m², në Ndërmarrjen e Prodhimit të Çelikeve, Elbasan”, nëpërmjet procedurave të konkurrimit.

2. Për dhënien me qira të zbatohen procedurat e përcaktuara në kreun II dhe kreun V të vendimit nr. 529, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.

3. Kriteret e konkurrimit për dhënien me qira të kësaj pasurie të jenë, si më poshtë vijon:

a) Pasuria jepet me qira, me qëllim zhvillimin e veprimtarive në fushën e industrisë përpunuese.

b) Nivelet e investimit që do të kryhen në këtë pasuri për zhvillimin e aktivitetit, të jenë në vlera mbi 10 (dhjetë) milionë euro.

4. Ofertat e pjesëmarrësve në konkurrim të vlerësohen me pikë, si më poshtë vijon:

a) Investimi 50 pikë

b) Punësimi 30 pikë

c) Koha e fillimit të punës 20 pikë.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha